



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02- Nr. 156-26

Me datë 26.06.2026

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në lidhje me nenet 72, 73, 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 lidhur me nenin 87 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, lidhur me deklaratën e dorëzuar për dorëheqje nga marrëdhënia e punës me nr. protokolli 08.Nr-19-26 të datës 24.06.2026 si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit publik

Neni I

z. Guxim Bytyqi, i sistemuar në vendin e punës sipas kontratës si Mjek i Përgjithshme pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik me datën 01.07.2026, në bazë të dorëheqjes së tij të paraqitur me vullnet të lirë.

Neni II

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, nga data 01.07.2026, ta largojë të lartpërmendurin nga lista e pagave, si dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.


Neni III

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.07.2026 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

z. Guxim Bytyqi, nga Komuna e Suharekës, ka ushtruar detyrën e Mjekut të Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, në përputhje me kontratën individuale të punës dhe detyrat e përcaktuara, deri më datën 30.06.2026, kur edhe i ndërpritet marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik, në bazë të dorëheqjes së paraqitur me vullnet të lirë.

z. Guxim Bytyqi, në cilësinë e nëpunësit publik, përmes shkresës së dorëzuar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale më datë 24.06.2026, i është drejtuar Drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke paraqitur deklaratën për dorëheqje, e cila është protokolluar me nr. 08.Nr-19-26 të datës 24.06.2026 Me këtë deklaratë, ka njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës në Shërbimin Publik, në pozitën Mjek i Përgjithshme pranë QKMF-së në Mamushë, me arsyetimin se do të fillon punën me një institucion tjetër.



Lënda: Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës

I/E nderuar/a,

Në përputhje me kushtet e kontratës së punës, me këtë shkresë ju njoftoj se kam vendosur të ndërpres marrëdhënien e punës.

Arsyeja: Ky vendim është marrë për shkak të vazhdimit të angazhimit tim profesional në një institucion tjetër.

Ju falënderoj për mundësinë, bashkëpunimin dhe përvojën e fituar gjatë periudhës së angazhimit tim në institucion. Gjatë periudhës së njoftimit do të vazhdoj të kryej detyrat e mia me përgjegjësi dhe profesionalizëm, si dhe do të kontribuoj në një dorëzim sa më të rregullt të obligimeve.

Data e fundit e punës: 30.06.2026

Me respekt,

Dr. Guxim Bytyçi

Mjek i Përgjithshëm

Data: 24.06.2026

Nënshkrimi: _____



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

ZYRA E KRYETARTI TË KOMUNËS

02 Nr. 155/26
Me 26.06.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023, lidhur me nenin 12, paragrafi 1 dhe 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 Regullore (QRK) - nr. 30/ 2024 Për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/I -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

V E N D I M

Komisioni i pranimi për pozitë të kategorisë profesionale në QKMF

- I. **Formohet:** Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim publik në pozitën Komisioni i pranimi për pozitë profesionale, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, dhe përbëhet nga:
- II. Komisioni i Pranimi në pajtim me nenin I të këtij vendimi përbëhet nga:
 - znj. Fitore Bytyçi- Kryesuese NJMBNJ
 - z. Abdulla Morina – anëtar Infermier
 - z. Kenan Morina- anëtar- Infermier
 - znj. Bilay Kazaz- anëtare Mjeke e Përgjithshme
 - znj. Arzu Orçuša- anëtare Mjeke e Përgjithshme.
- III. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe regullore (qrk) - nr. 30/ 2024 për procedurën e pranimi të nëpunësve të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë.

Kryetar i Komunës së Mamushës

Abdullah KRASNIÇ





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 154/26
Me 26.06.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.68/24 e datës 02.10.2024, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 16.07.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-69-25 i datës 20.10.2025 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 7,100.00 € sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 18.06.2026, pagesa për periudhën e muajit qershor 2026, sipas numrit të zotimit 2026-100429.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
3. Palëve
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02-153/26

Me datë 25.06.2026

Kryetari i Komunës së Mamushës, pas shqyrtimit të propozimit me numër të protokollit 06.Nr.20/26 e datës 24.06.2026, të paraqitur nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, lidhur me Ligjin Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, Ligji NR. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Statutin e Komunës së Mamushës, si dhe dispozitat të tjera ligjore në fuqi, Kryetari i Komunës së Mamushës me datën 25.06.2026 morri këtë:

V E N D I M

- I. **Lejohet**- fillimi i procedurave për hapjen e diskutimit publik për draft raportin e vlerësimit strategjik mjedisor për hartimin e planit zhvillimor komunal të Mamushës 2026-2034, bazuar në propozimin me numër të protokollit 06.Nr.20/26 e datës 24.06.2026, të paraqitur nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër.
- II. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave për hapjen, organizimin dhe përfundimin e diskutimit publik është komprencë e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, në bashkëpunim me zyrat dhe njësitë tjera përkatëse të Komunës së Mamushës.
- III. Data, koha dhe vendi i mbajtjes së diskutimit publik me qytetarët e Komunës përcaktohet nga Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, në koordinim me akter të tjerë të cilët marrin pjesë në diskutimi publik.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



BELEDİYE BAŞKANLIĞI OFİSİ

No: 02- 15/26
Tarih: 25.06.2026

Mamuşa Belediye Başkanı, İmar, Şehircilik, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğü tarafından sunulan 24.06.2026 tarihli ve 06.Nr.20/26 sayılı öneriyi değerlendirdikten sonra; 03/L-040 Sayılı Yerel Yönetimler Kanunu, 04/L-174 Sayılı Mekânsal Planlama Kanunu, 03/L-230 Sayılı Stratejik Çevresel Değerlendirme Kanunu, Mamuşa Belediyesi Tüzüğü ve yürürlükte bulunan diğer ilgili mevzuat hükümlerine dayanarak, 25.06.2026 tarihinde aşağıdaki kararı vermiştir:

K A R A R

I. Mamuşa Belediyesi 2026–2034 Belediye Gelişim Planının hazırlanmasına ilişkin Stratejik Çevresel Değerlendirme Taslak Raporu için kamuoyu görüşme sürecinin başlatılmasına izin verilir. Bu karar, İmar, Şehircilik, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğü tarafından sunulan 24.06.2026 tarihli ve 06.Nr.20/26 sayılı teklife dayanmaktadır.

II. Kamuoyu görüşme sürecinin açılması, düzenlenmesi, yürütülmesi ve tamamlanmasına ilişkin işlemlerin gerçekleştirilmesi ve denetlenmesi, Mamuşa Belediyesinin ilgili diğer birimleri ile iş birliği içerisinde İmar, Şehircilik, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğünün yetki ve sorumluluğundadır.

III. Vatandaşlarla gerçekleştirilecek kamuoyu görüşmesinin tarihi, saati ve yeri, İmar, Şehircilik, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğü tarafından, görüşme sürecine katılan diğer paydaşlarla koordinasyon içerisinde belirlenir.

IV. Bu karar, Belediye Başkanı tarafından imzalandığı tarihte yürürlüğe girer.

Mamuşa Belediye Başkanı

Abdülhadi Krasnić





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 152/26
Me 26.06.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, pika 10.4 e Procedurës për Regjistrimin e Përfituesve Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

AKTVENDIM
Regjistrimi furnitor ndërkombëtar në SIMFK

Neni 1

Konform aktëve ligjore në fuqi miratohet regjistrimi i furnitorëve ndërkombëtar në SIMFK, me të dhënat si në vijim:

Nr.	Përfituesi	Emri i Bankës	Xhirollogaria	Bank Swift Code	Shuma €
1	BOGOVINJA MUNICIPALITY- REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA	TREASURE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA	705014095978A3	NBRMMK2A	32,470.00
2	INNOVATION CENTER FOR COMMUNITY DEVELOPMENT (IC4CD)	UNIVERSAL INVESTMENT BANK AD SKOPJE	2401901222451898	UIBMMK22XXXX	7,800.00

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF
- Thesari-MF
- Arkiva

Procedurë për Regjistrimin e Përfituesve
Sistemin Informativ të Menaxhimit
të Financave të Kosovës

Kryetar i Komunës së Mamushës
Abdullah Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 151-26
Me 25/06 -2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “Matje Kadastrale në Mamushë”

- 1. z Güner Morina** Drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, Caktohen persona përgjegjës nga njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit **“Matje Kadastrale Mamushë”**
- 2.** Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
- 3. Obligohen-** personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 150 -26
Me 24 / 06 -2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “Sigurimi TPL Dhe TPL+ I Automjeteve Zyrtare të Komunës së Mamushës”

- 1. Z. Yahya Şala** Drejtor i Administratës së Përgjithshme **z.Levent Mazrek** Drejtor i Shërbimeve Publike dhe **z.Emre Şala** Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Caktohen persona përgjegjës nga njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit “**Sigurimi TPL Dhe TPL+ I Automjeteve Zyrtare të Komunës së Mamushës**”
- 2.** Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
- 3. Obligohen-** personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklarohen se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 149-26
Me 23/06-2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe Infrastruktura përcjellëse e rrugëve fushore bujqësore kliqka-Torazhda”

1. **Z. Labinot Muhaxheri-** Zyrtar i Lartë për buxhet dhe financa në Drejtorinë e Bujqësisë, Caktohet person përgjegjës nga njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit “ ***Rregullimi dhe Infrastruktura përcjellëse e rrugëve fushore bujqësore kliqka-Torazhda***”
 2. Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
 3. **Obligohen-** personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.
- 3.1.** Deklaratë me të cilën deklarohen se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzoj specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 148-26
Me 22/06-2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “Kubëzimi në lagjet Yenimahale-Ortamahale-Sehitlermahale- Rrugët Kisla- Cumuriyet- Bahçelik- Huriyet-Pasa-Asker- Demirci- Kliqka- Torazhda dhe Kultur”

NENI 1

Z. Levent Mazrek- Drejtor i Shërbimeve Publike Caktohet person përgjegjës nga njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit “***Kubëzimi në lagjet Yenimahale- Ortamahale-Sehitlermahale- Rrugët Kisla- Cumuriyet- Bahçelik- Huriyet-Pasa-Asker- Demirci- Kliqka- Torazhda dhe Kultur***”.

NENI 2

Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

NENI 3

Obligohen- personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasnic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 147 /26
Me 22.06.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesë

Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik Milazim Zeqiri B.I, sipas fletëpagesës nr. 01/26 sipas përshkrimit Kapja dhe asgjësimi i qenëve endacak.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria “Mallra dhe Shërbime”, sipas përshkrimit, “Kapja dhe asgjësimi i qenëve endacak” në shumën 100.00 €, sipas bllokut kodues: 10/626/18014/13470/00000/0451, për: Milazim Zeqiri B.I Numri unik i biznesit: **811927625** Llogaria bankare: 1301001003524887.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Pas thirrjes nga stacioni policor në Komunën e Mamushës me datën 18.05.2026, me rastin e një qeni me rezikshmëri të lartë, pasi që i kishte sulmuar shumë persona. Po në datën e lartëcekur qeni është kapur, është eutanizuar në mënyrë njerëzore në prezenc të policisë, dhe më pas është groposur.

E gjithë ky veprim është kryer në bazë të procedurave ligjore dhe asgjësimi i qenit në fjalë është bërë me vlerësim të rezikshmërië nga vetrinari Milazim Zeqiri, i cili të gjitha procedurat e duhura i ka kryer pas thirrjes së policisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtoria përkatëse
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 146 /26
Me 22.06.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Rregullore (QRK) nr.06/2023 për kompenzimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

AKTVENDIM

Regjistrimi furnitor në SIMFK për avans për udhëtime jashtë vendit

Neni 1

Konform aktëve ligjore në fuqi miratohet regjistrimi i furnitorëve në SIMFK për avans për udhëtime jashtë vendit, me të dhënat si në vijim:

Përfituesi	Pozita	ID	Xhirollogaria/ Banka
Necmedin Morina	Kryesues i Kuvendit Komunal	10700000000000000000	17000000000000000000 R
Hasan Kruezi	Zyrtar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Erhan Mazrek	Anëtar i Kuvendit Komunal-Mamushë	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Ramadan Zogaj	Nënkryetar i Komunës për Komunitete	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Emre Şala	Drejtor i Mirëqenjes Sociale dhe Shëndetës	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Güner Morina	Drejtor për Planifikim, Urnanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Buyar Mazrek	Drejtor për Arsim, Shkenc, Rini, Kultur dhe Sport	10700000000000000000	17000000000000000000 NED
Recep Morina	Drejtor për Zhvillim Ekonomik	10700000000000000000	17000000000000000000 NED

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF
- Thesari-MF
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 145 -26
Me 15.06 -26
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 9 dhe 72A të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me nenin 26, 44, 45, 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

“Për caktimin e komisionit për Pranim teknik të punëve”

1. **Caktohet** komisioni për pranimin teknik sipas kontratës me titull të prokurimit “**RREGULLIMI I INFTRASTRUKTUARËS PËRCJELLËSE TË RRUGËVE FUSHORE BUJQËSORE LESKA-NISRA-LIKA-ASKER Punë shtesë** - me nr. të prokurimit: 626-26-2515--5-2-5 dhe nr. të brendshëm: 626-26-004-5-2-5 .

Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

- 1.1. Labinot Muhaxheri– Kryetar i komisionit
- 1.2. Esra Osi – Anëtare
- 1.3. Bilnur Bitiçi – Anëtare

2. Komisioni për pranim teknik ka përgjegjësi që të bëjë konstatimin e punëve të kryera sipas kontratës dhe specifikave të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblertjen sipas projektit **RREGULLIMI I INFTRASTRUKTUARËS PËRCJELLËSE TË RRUGËVE FUSHORE BUJQËSORE LESKA-NISRA-LIKA-ASKER Punë shtesë** - me nr. të prokurimit: 626-26-2515--5-2-5 dhe nr. të brendshëm: 626-26-004-5-2-5 .

3. Komisioni për pranimin teknik do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe të bëjë pranimin e punimeve të kryera sipas njësisë kërkuese

4. Komisioni duhet të hartoj një raport për menaxherin e kontratës, dhe zyrën e Prokurimit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit , menaxheri i kontratës

6. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria përkatëse
2. Zyra e Prokurimit dhe
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 144/26

Me 15.06.2026

Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Automjetit

Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik Kosova Motors J.S.C, sipas fletëpagesës nr.1004/26, e datës 02.06.2026 për servisin e rregullt të automjetit të tipit Ford Kuga, me targa 04Z-18-32 dhe numër të shasisë WFOFXXWPHPM23262.

Neni 2

Mjetet financiare që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria buxhetore “Mallra dhe Shërbime”, sipas përshkrimit “Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjetit Ford Kuga me targa 04Z-18-32 dhe numër të shasisë WFOFXXWPHPM23262”, në shumën 239.44 €, për përfituesin operatorin ekonomik Kosova Motors J.S.C, me numër unik të biznesit 811277591 dhe llogari bankare 1401000000379740, sipas bllokut kodues: 10/626/16314/14010/00000/0133 dhe zotimi 2026-94017.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

